



**31.10.2018**

Fondi për Zhvillimin e Komunitetit si Përfituesi Kryesor i Granteve të Fondit Global për zbatimin e Programeve të Tuberkulozit dhe HIV-it në Kosovë shpall:

## **Vend pune për pozitën Infermier/e për Njësinë Mobile**

**I raporton:** Zyrtarit për M&E, CDF

Pozitë me orar të plotë (40 orë për javë)

### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

Infermieri/ja për Njësinë Mobile ka për detyrë dhe është përgjegjës/e:

- Të ofrojë shërbimet e këshillimit parandalues për HIV dhe IST, duke përfshirë edhe këshillat e shëndetit riprodhues dhe seksual dhe higjienës personale.
- Të ofrojë shërbimet e këshillimit dhe testimit për HIV në bazë të Udhërrëfyesit dhe Protokollit për Testim dhe Këshillim Vullnetar;
- Të ofrojë shërbimet e testimit (marrja e mostrave të gjakut për testim vullnetar për HIV, Hepatit B, Hepatit C dhe Syfillis sipas nevojës);
- Të regjistrojë rezultatet e këshillimit dhe testimit për të gjithë klientët në formularët përkatës të standardizuar, të disagreguar për grupet e caktuar dhe ti dorëzojë në CDF;
- Të ofrojë shërbimet tjera infermiore sipas nevojës, sic janë: pastrimi i plagëve-mobilizimi i tyre, matja e tensionit, etj;
- Të përgadisë pjesën ambulatore të Njesisë Mobile duke u kujdesur për furnizimin dhe vendosjen e materialeve dhe produkteve të nevojshme për testim dhe shërbime bazike infermiore. Në fund të ditës së terrenit të kujdeset që të pastrojë pjesën ambulatore nga materialet e përdorura shëndetësore dhe të dezinfektojë hapësirën;
- Të jetë përgjegjës/e për referimin e klientëve në institucionet përkatëse për trajtim dhe ndihmë të mëturshme duke filluar nga niveli primar shëndetësor e deri te IKSHP për testim konfirmues;
- Të kryejë punë organizative për Njësinë Mobile, sipas nevojës;
- Të bashkëpunojë me Mobilizuesit Social të OJQ-ve që punojnë me grupet e caktuar;
- Të asistojë në monitorimin edhe evaluimin e aktiviteteve dhe raportimit të brendshëm të CDF;
- Në rast të përfundimit të kontratës, ose largimit/leshimit të pozitës, është përgjegjës/e të bëjë dorëzimin e detyrave dhe përgjegjësiave sic parashihet me rregullat e brendshme të CDF;
- Të bashkëpunojë dhe koordinojë me stafin e OJQ-ve që punojnë me grupet e caktuar dhe Asociacionin e Personave që jetojnë me HIV, lidhur me referimin e rasteve;
- Të jetë i gatshëm për detyra tjera shtesë në rrethana specifike dhe sipas nevojës.

### **Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuesit:**

- të ketë të përfunduar nivelin bachelor në infermieri;
- të jetë i/e Licencuar nga MSH gjegjësisht Oda e Infermierëve të Republikës së Kosovës;
- së paku dy vjet përvojë si infermier/e në Institucionet Publike ose Private, në Organizata Jo-Qeveritare apo në organizata ndërkombëtare;
- të ketë shkathtësi koordinuese;

CDF is an Equal Opportunity Employer. Candidates will receive consideration without regard to race, color, religion, national origin, disability, age or sexual orientation.

- përvoja e punës me agjensione ndërkombëtare e preferuar;
- të ketë shkathtësi ndërpersonale të mira dhe të punojë në ekip;
- aftësi të dëshmuara që të punojë në ambiente komplekse multisektoriale;
- i/e gatshëm të jetë fleksibil në orar të punës me qëllim të arritjes së objektivave të programit dhe të marrë përsipër detyra shtesë nëse kërkohet nga Menaxheri i Programit;
- Njohja e gjuhëve zyrtare të Kosovës.
- CV me tre (3) referenca të verifikueshme dhe kopje të skanuar të Diplomës per nivelin bachelor në infermieri duhet të dorëzohen në CDF, me e-mail në [procurement.hiv.tb@kcdf.org](mailto:procurement.hiv.tb@kcdf.org), jo më vonë se 08 Nentor 2018 në orën 16:00.

Termat e Referencave për këtë pozicion mund të merren edhe në faqen e internetit të CDF: [www.kcdf.org](http://www.kcdf.org).

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për një intervistë.